



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Tiranë, më 01.11.2024

Lënda: Kthim përgjigje

N. M

Në lidhje me kërkesën tuaj të datës 30.10.2024, adresuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet e-mailit zyrtar: kontakt@issh.gov.al, me anë të së cilës kërkon; *për tu pajisur me kopje të barazvlefshme të marrëveshjes dhe aneks marrëveshjes së nënshkruar midis Institutit të Sigurimeve Shoqërore me nr. 6092 prot, datë 11.07.2023 dhe Postës Shqiptare SHA nr.1425 prot, datë 11.07.2023 "Për pagesën e pensioneve dhe përfitimeve të tjera nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore"*, ju informojmë se:

Bazuar në nenin 7, të Ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në faqen zyrtare të ISSH, <http://www.issh.gov.al>, në rubrikën "Dokumentat e Hapura"/ Marrëveshje, ka publikuar: [Marrëveshja ISSH/ Posta shqiptare sha / 11.07.2023](#) dhe Aneks Marrëveshjen përkatëse, të cilat mund të përdoren nga çdo individ apo subjekt që paraqet interes për këtë informacion.

Bashkëlidhur në attachment po ju dërgojmë kopjen e Marrëveshjes dhe Aneks Marrëveshjes *"Për pagesën e pensioneve dhe përfitimeve të tjera nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore"*, të lidhur midis Institutit të Sigurimeve Shoqërore me nr. 6092 prot, datë 11.07.2023 dhe Postës Shqiptare SHA nr.1425 prot, datë 11.07.2023".

Ju falenderoj për mirëkuptimin!